



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FINIQ
AUTORITETI KONTRAKTOR

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nr. _____ Prot.
05.05.2020

Data

Për: **Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “HE & SK 11” sh.p.k. & “Arena MK” sh.p.k.**, me NIPT L19008502B / L67619801Q.

Procedura e prokurimit: **“Kerkese per propozim”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-53700-03-10-2020**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **”Supervizion punimesh për objektin “Ujësjiellësi Rajonal i Finiqit (Linja e jashtme) Burimet e Merkos”**.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 24 muaj.

Fondi limit: 4,231,296 (Kater milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e nentëdhjetë e gjashtë) Lekë pa t.v.sh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **30.03.2020**.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 12 datë 17 Mars 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve ekonomik **“INSTITUTI DEKLIADA - ALB” sh.p.k. & “6D – PLAN” sh.p.k.** regjistruar si person juridik ne QKB me NUIS K71606006A / L62717405H.
Vlera 3,380,805.50 leke (Tre milion e treqind e tetëdhjetë mijë e teteqind e pese presje pesëdhjetë) Leke pa tvsh dhe 4,056,966.60 (Kater milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nentëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë) Leke me tvsh.

(me numra dhe fjalë)

2. Bashkimi i Operatoreve ekonomik **“HMK - Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k.** regjistruar si person juridik ne QKB me NUIS L57129604Q / K61617040L.
Vlera 3,494,392 (Tre milion e katerqind e nentëdhjetë e kater mijë e treqind e nentëdhjetë e dy) Leke pa t.v.sh. dhe 4,193,270.4 (Kater milion e njëqind e nentëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë presje kater) Leke me t.v.sh.

(me numra dhe fjalë)

3. Operatori ekonomik “HE & SK 11” sh.p.k. & “Arena MK” sh.p.k., me NIPT L19008502B / L67619801Q.

Vlera 3,708,146.667 (Tre milion e shtateqind e tete mije e njeqind e dyzet e gjashte presje gjashteqind e gjashtedhjet e shtate) Leke pa t.v.sh. dhe 4,449,776 (Kater milion e katerqind e dyzet e nente mije e shtateqind e shtatedhjet e gjashte) Leke me t.v.sh.

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” sh.p.k. & “6D – PLAN” sh.p.k. regjistruar si person juridik ne QKB me NUIS K71606006A / L62717405H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi i Operatoreve ekonomik “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” sh.p.k. & “6D – PLAN” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion te plote për këtë procedurë prokurimi, konkretisht:

Se pari, Ing. Saidion Kodhelaj është me kohe te plote tek shoqeria “6D Plan” sh.p.k. si Administrator, nuk ka license per Mbikqyrje punimesh, nuk ka 15 vite pune vjetersi sidhe ne te njejten kohe, është me kohe te pjesshme si ing. tek Dekliada –ALB.

Se dyti, Bashkimi i Operatoreve ekonomik “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” sh.p.k. & “6D – PLAN” sh.p.k. nuk ka arkitekt restaurator sipas DST.

Se treti, Oferta e paraqitur është nen vleren minimale te Mbikqyrjes së punimeve 4 449 767 Lekë (ME TVSH) llogaritur ne baze të VKM 354 datë 11.05.2016 “Per miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim.

Sipas, shkresës nr. 5585 prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik drejtuar Autoriteteve Kontraktore theksohet se AK gjatë vlerësimit të ofertave duhet ti referohen dhe te kene ne konsiderate vlerën minimale të përlllogaritur sipas VKM-së 354 datë 11.05.2016.

Sipas shkreses nr. 417 prot. date 11.02.2020 te Agjencise Kombetare te Ujesjelles Kanalizimeve dhe Infrastuktures se Mbetjeve drejtuar Bashkise Finiq, llogaritja e vleres se Mbikqyrjes se punimeve per kete objekt është bere ne baze te Vkm. nr. 354 date 11.05.2016, e reflektuar kjo ne ndarjen e fondit.

2. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “HMK - Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. regjistruar si person juridik ne QKB me NUIS L57129604Q / K61617040L.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Me datë 24.04.2020 rezulton se nëpërmjet shërbimit postar është paraqitur prane autoritetit kontraktor Bashkia Finiq ankesa nga bashkimi i operatorëve ekonomik “HMK-Consulting” & “TAULANT” sh.p.k. me përfaqësues shoqërine “HMK-Consulting” sh.p.k., me Nr. 32/3 Prot. datë 17.04.2020, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Ankesë e cila është protokolluar nga ana Jonë me hyrje Nr. 1271 Prot. datë 24.04.2020.

Bashkia Finiq, sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar përkatësisht: “[...] “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”. “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”. “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, “Ankesa në autoritetin kontraktor” ku citohet: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim. 2. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP. Në rastin e procedurave me mjete elektronike, procesi i pezullimit bëhet sipas udhëzimeve të APP-së. 3. Ankimesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban emrin, adresën, adresën elektronike të ankimesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet. Nëse mungon ndonjëri nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet nga zyrtari përkatës. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve pas njoftimit, ajo vlerësohet si e paparaqitur. Formulari i ankesës është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, të cilat janë të publikuara në faqen e internetit të APP-së.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në lidhje me këtë procedurë prokurimi, rezulton se ankesa e tij është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 24.04.2020, nepërmjet shërbimit postar. Në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, “*strictu sensu*” parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar Autoriteti Kontraktor Bashkia Finiq vëren se, ankimi i bashkimit të operatorëve ekonomik “HMK-Consulting” & “TAULANT” sh.p.k. me përfaqësues shoqërië “HMK-Consulting” sh.p.k., nuk është bërë në formën sipas (me shkrim) formularit standard të ankesës, pjesë e dokumentave të tenderit brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi.

Sa më sipër, ankimi administrativ i dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nuk është dorëzuar në formën dhe mënyrën e parashikuar nga “*lex specialis*”, duke mos e legjitimuar “*ratione temporis*” operatorin ekonomik ankimues në dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor një ankesë të hartuar në kundërshtim me formën dhe mënyrën që parashikojnë dispozitat ligjore të LPP-së., c’ka përbën shkak të mospërbushjes të kushteve formale, pasi operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor në datën 24.04.2020 në kundërshtim me nenin 63 pika 2 e LPP-së, që përcakton shprehimisht se ankimi duhet bërë me shkrim brenda 7 ditëve nga dita e nesërme që është vënë në dijeni apo duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar. Autoriteti kontraktor Bashkia Finiq vëren se, ankimi nuk është nisur përmes një rruge të pranuar nga pikpamja procedurale (Kodi i Procedurave Administrative), pra me shkrim brenda afateve të përcaktuara nga LPP. Operatori ekonomik, nuk ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor siç edhe është parashikuar nga ligji Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), ky i fundit është treguar neglizhent dhe i papërgjegjshëm për fatin e ankimit të tij, pasi ishte apo duhej të ishte e qartë për të se ankesa pranë autoritetin kontraktor “*stricu lege*” referuar nenit 63 pika 2 duhet të kryhet në formë shkresore brenda afatit ligjor.

Autoriteti kontraktor Bashkia Finiq rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i ezaurimit të shkallëve të ankimit, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si “*lex specialis*” mbi lëndën.

Sa më sipër autoriteti kontraktor Bashkia Finiq konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk janë ndjekur shkallët e ankimit në respekt të nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 ku parashikohet se: “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji” (pika 2) Respektimi i këtyre elementëve të sipërcituar janë të domosdoshmëm për shqyrtimin e ankesës.

Autoriteti kontraktor Bashkia Finiq e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit

e bën ankesën të pavlefshme”. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkalleve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, ka krijuar tashme nje praktike të konsoliduar në lidhje me formën e paraqitjes së ankesave nga operatorët ekonomike sidhe respektimit të afateve të ankimit. Kam parasysh vendimet e KPP-së Nr. 604/2017, datë 10.08.2017, Nr. 109, datë 07.03.2017, Nr. 473, datë 29.06.2017 etj.

Akoma dhe më tej, bashkimi i operatorëve ekonomik “HMK-Consulting” & “TAULANT” sh.p.k. me përfaqësues shoqërine “HMK-Consulting” sh.p.k., nuk ka arritur të plotësoj kriteret për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor Bashkia Finiq, konkretisht,

Së pari, bashkimi i operatoreve ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. nuk ka arritur të plotësoj kriteret për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor, konkretisht, nuk ka arritur të plotësoj pikën: *Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen: a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme.*

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. është krijuar nëpërmjet Akt Marrëveshjes Nr. Repertorit 1892, Nr. Koleksionit 554, datë 24/03/2020. Në pjesën hyrëse të Akt Marrëveshjes është përcaktuar se: *“Palet kontraktuese, me vullnetin e tyre të lire e të plote, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, perkatesisht nenit 659, 1074, e vijues të tij, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Per Prokurimin Publik” dhe Udhëzimit të K.M. Nr. 1 datë 10.01.2007, në zbatim të ligjit për prokurimin publik, bien dakort të hartojnë kete Akt – Marrëveshje për të krijuar nje shoqeri të thjeshte sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme: Baza e kesaj marreveshje te perbashket Joint/Venture eshte qe cdo anetar i Joint – Venture ne menyre individuale dhe te perbashket eshte pergjegjes per ekzekutimin e kesaj kontrate”.* Në nenin 8 të Akt – Marrëveshjes, është përcaktuar se: *Kjo Akt – Marrëveshje u përpilua në baze të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007 “Për disa ndryshime në ligjin “Për Prokurimin Publik”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 153, datë 22.03.2007.*

Hartimi i Akt – Marrëveshjes Nr. Repertorit 1892, Nr. Koleksionit 554, datë 24/03/2020 për krijimin e bashkimit të operatoreve ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. përben një akt administrativ të pavlefshëm, kjo pasi, bazuar në ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Baza ligjore e hartimit të Akt – Marrëveshjes, konkretisht vendimi Nr.1, datë 10.1.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është shfuqizuar me

vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili në pikën 4 të tij, ka vendosur: 4. **Vendimi nr.1, datë 10.1.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe të gjitha udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, të dala në zbatim të këtij vendimi, shfuqizohen.**

Në ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 107 “Ligjshmëria e aktit administrativ”, është përcaktuar se: Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi. Në nenin 108 “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”, është parashikuar se: Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Në nenin 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ”, është parashikuar se: Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës; b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi; d) është në kundërshtim me ligjin material; dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Sa më sipër, baza ligjore e krijimit të bashkimit të operatoreve ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës / shërbimit / furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Së dyti, Oferta ekonomike e paraqitur nga BOE “HMK CONSULTING” & “TAULANTI” sh.p.k. është poshte vleresimit minimale të mbikqyrjes së punimeve, e cila nga perlllogaritjet e bëra rezulton 3,708,139 Lekë pa t.v.sh., vlerë e përlllogaritur në baze të VKM-së Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim”. Sipas rekomandimit me shkresën me Nr. 5585 prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik, drejtuar autoriteteve kontraktore, theksohet se: Sipas pikës 3, Ne paraqitjen e ofertave në këtë lloj procedure prokurimi, operatorët ekonomike duhet të mbajnë në konsideratë edhe vlerat minimale të përlllogaritura nga autoritetet kontraktore në zbatim të VKM Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim”. Vlera minimale e kësaj procedure prokurimi është 3,708,139 Lekë pa t.v.sh., kurse oferta ekonomike e paraqitur nga BOE “HMK CONSULTING” & “TAULANTI” sh.p.k. është 3,494,392 Lekë pa t.v.sh.

Sa më sipër, vlera e ofertuar nga BOE “HMK CONSULTING” & “TAULANTI” sh.p.k. nuk është në përputhje me VKM Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim dhe rekomandimin e APP-së, pasi është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate. Kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikqyrjes dhe kolaudimit të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura. Autoriteti kontraktor sqaron se është detyrë e operatoreve ekonomike të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Në rastin në fjalë BOE “HMK CONSULTING” & “TAULANTI” sh.p.k. ka ofertuar me vlerë e cila rezulton të jetë nën vlerën minimale të lejuar të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi. Komisioni i Prokurimit Publik, ka krijuar tashme një praktikë të konsoliduar në lidhje me këtë ceshtje, kam parasysh vendimin Nr. 39/2020, datë 27.01.2020.

Së treti, Operatori Ekonomik “HMK CONSULTING” sh.p.k. nuk plotëson kriterin “punë të ngjashme” sipas përqindjes të përcaktuar në kontratën e bashkepunimit. Vlera totale e punimeve të ngjashme duhet të ishte sipas përqindjes së përfaqësimit 423,128 Lekë pa t.v.sh., kurse në fakt ka paraqitur “punë të ngjashme” me vlerë të realizuar prej 411,232 Lekë pa t.v.sh.

Së katërti operatori ekonomik “HMK CONSULTING” sh.p.k. është edhe hartuesi i projektit “Ujësjiellësi Rajonal i Finiqit (Linja e jashtme) Burimet e Merkos” në bazë të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se operatori ekonomik është në konflikt interesi dhe nuk mund të jetë Mbikqyrës i punimeve të zbatimit të këtij projekti bazuar në nenin 37 pika 3 të këtij vendimi. *Nga ana tjetër, konsulentit i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen ose zbatimin e një projekti dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohen nga furnizimi i mallrave, kryerja e punëve ose shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës) që rrjedhin ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për këtë përgatitje ose zbatim.*

Së pesti, bashkimi i operatoreve ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. nuk ka arritur të plotësojë kriteret për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor,

konkretisht, nuk kanë arritur të plotësoj pikën 3. *Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij dhe te figurojne ne licencen e shoqerise me pozicionin drejtues teknik:*

o **Arkitekt**

Per specialistet e mesiperm operatori ekonomik duhet te paraqese kontratat noteriale te punes te vlefshme gjate gjithe kohezgjatjes se punes, diplomat, cv, dhe licencat profesionale:

Drejtuesit teknike te siperpermendur duhet te jene ne listpagesat e shoqerise per periudhen Janar 2019 – Janar 2020

Bashkimi i operatoreve ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. ka paraqitur si arkitekt staf kryesor Z. Redi Pasko, Z. Kristi Roshanji, Z. Belina Kodra. Asnjëri nga personeli sa më sipër nuk plotëson kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, konkretisht, Z. Redi Pasko nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë “Taulant” sh.p.k. për periudhen Janar 2019 – Janar 2020; Z. Kristi Roshanji nuk rezulton të jetë drejtues teknik pranë shoqërisë “HMK Consulting” sh.p.k. sidhe nuk është paraqitur licenca për ushtrimin e profesionit; Zj. Belina Kodra nuk rezulton të jetë drejtues teknik pranë shoqërisë “Taulant” sh.p.k.

Së gjashti, bashkimi i operatoreve ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. nuk kanë arritur të plotësojnë kriteret për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor, konkretisht, nuk kanë arritur të plotësoj pikën: *Operatori ekonomik te kete pjese te stafit ekspert te vleresimit ne mjedis i pajisur me licence nga QKL si dhe Arkitekt Restaurator.* Bashkimi i operatoreve ekonomike “HMK Consulting” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. ka paraqitur si arkitekt restaurator Z. Faikojon Belaj, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, kjo pasi nuk rezulton të jetë drejtues teknik pranë shoqërisë “HMK Consulting” sh.p.k.

Së shtati, shoqëria “Taulant” sh.p.k. nuk plotëson kriteret për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor, konkretisht, nuk ka arritur të plotësoj pikën 5. *Operatori Ekonomik duhet te vertetoje me Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit: Numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 17 shtatembedhjetë) punonjës ne muaj për periudhën Janar 2019 – Janar 2020. Per kete kriter, operatori ekonomik duhet te paraqese detyrimisht: 1.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar 2019 – Janar 2020. Shoqëria “Taulant” sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin Nr. T01902623, datë 05.03.2020, ku rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 259,912 Lekë, nga të cilat: Kontribute gjithsej 259,912 Lekë. Në shtojcën 4 “Deklaratë mbi Përmbushjen e Kriereve të Përgjithshme” shoqëria “Taulant” sh.p.k. deklararon se: Operatori ekonomik "Taulant" sh.p.k ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Shoqëria “Taulant” sh.p.k. ka paraqitur deklaratë me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, parashikuar nga ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 13, pika 3, germa “a”.*

Së teti, shoqëria “Taulant” sh.p.k. nuk plotëson kriteret për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor, konkretisht, nuk ka arritur të plotësoj pikën dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Shoqëria “Taulant” sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin Nr. 385 Prot. datë 21.02.2020, në të cilën është deklaruar se subjekti nuk ka detyrime të pa likujduara për faturat e energjise elektrike deri në datë 19.02.2020. Vërtetimi Nr. 385 Prot. datë 21.02.2020 i paraqitur nga shoqëria “Taulant” sh.p.k. është marrë përtej afatit 30 ditore nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, e cila është zhvilluar me datë 30.03.2020. Shoqëria “Taulant” sh.p.k. nuk ka arritur të paraqes dokumentacion të plotë për plotësimin e këtij kriteri.

Së nenti, shoqëria “HMK Consulting” sh.p.k. nuk plotëson kriteret për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor, konkretisht, nuk ka arritur të plotësoj pikën 5. *Operatori Ekonomik ose bashkimi i operatorve ekonomike duhet të vërtetojë se është i pajisur me Certifikatat që vërtetojnë plotësimin e kapaciteteve të cilësisë të organizimit dhe zbatimit të standartave në aktivitetin e vet në lidhje me fushat meposhtme:*

- BS ISO 39001 : 2012 (Per sigurine ne trafikun rrugor)

- ISO 50001:2011 (Per sistemin e menaxhimit te energjise)

- BS PAS 99:2012 (Studimi, projektimi i objekteve te ndertimeve e civile. Mbikqyrja dhe kolaudimi i punimeve te ndertimit)

Në vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 74 Bashkimi i operatorëve ekonomikë, ku përcaktohet se: 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shoqëria “HMK Consulting” sh.p.k. nuk ka paraqitur certifikatat ISO 39001:2012; 50001:2011; PAS 99:2012. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomike Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatoreve Ekonomik** “HE & SK 11” sh.p.k. & “Arena MK” sh.p.k., me NIPT L19008502B / L67619801Q, me adrese: Gjirokaster Tepelene TEPELENE Lagjja " Mustafa Matohiti", Rruga "Mustafa Matohiti", banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe / Fier Qender - MALLAKASTER DUKAS Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndertesa private Nr.2, Zona kadastrale 1566, Nr.pasurie 93/14 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3,708,146.667 (Tre milion e shtateqind e tete mije e njeqind e dyzet e gjashte presje gjashteqind e gjashtedhjet e shtate) Leke pa t.v.sh. dhe 4,449,776 (Kater milion e katerqind e dyzet e nente mije e shtateqind e shtatedhjet e gjashte) Leke me t.v.sh. /pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Finiq, adresa 9716 Finiq Vlore, Tel/Fax +355695812997 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **15.04.2020**

Ankesa: ka ose jo Po, ka ankese me date 24.04.2020.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 28.04.2020.

Njoftimi i fituesit ne baze te Vendimit te K.P.P. 189/2020 .

[Titullari i autoritetit kontraktor]

KRYETARI BASHKISE
KRISTO KIÇO